



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:285452

Datë: 07.11.2024

Numri i dokumentit: 06469419

2024:285453

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurit D.H. nga fsh., për shkak të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm PP/II.nr.868/24, e dt.10.10.2024, ka mbajtur shqyrtimin fillestar publik më datë 01.11.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Avdullah Abedini dhe të pandehurit, dhe po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 07.11.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri D.H., nga i ati I., e ëma E., gjinisë R., lindur me datë, në, me vendbanim në fshatin Komuna Shtime, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, me profesion programer, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal, i dënuar edhe më parë për vepra penale të ndryshme, ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë 05.06.2024, rreth orës 00:30 h në rrugën “.....”tek nënkalimi në Ferizajt, i pandehuri pa autorizim ka poseduar substanca apo preparate, të cilat me ligj janë shpallur si narkotik, në atë mënyrë deri sa ishte duke e drejtuar veturën e tij tipit me tabela, është ndaluar nga patrulla policore dhe gjatë kontrollës të njëjtit iu është gjetur një sasinë e narkotikut, me ç’ rast e njëjta i konfiskohet dhe nga raporti i ekspertimit me numër referues AKF/2024-2398/24-2280 i datës 13.09.2024, në konstatimin dhe mendimi përfundimtar ka rezultuar se dëshmia 1 përmban Kanabis (Marihuanë) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), në peshë neto : 1.38=0,0001 gram.

me këtë ka kryer veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 69 ,70 dhe 269 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe neni 364 dhe 452 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të pandehurin e :

G J Y K O N

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 /një / viti dhe me dënim në të holla në shumë prej 200 € /dyqind euro/. Dënimi i shqiptuar me burg nuk do të ekzekutohet me kusht që i pandehuri brenda afatit prej 1 /një/ viti, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale (koha verifikimit), në të kundërtën dënimi i tillë mund të revokohet, ndërsa dënimin e shqiptuar me gjobë është e obliguar ta paguajnë në afat prej 30 /tridhjetë/ ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par. 3 të KPRK-së, i njëjti dënim do t’i shëndrrohen në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t’u llogaritet nga një (1) ditë burgim.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 20 Euro /njëzetë/, ndërsa në emër kompensimin të Viktimave të Krimit shumë prej 20 € (njëzetë euro), në kuptim të nenit 36 par. 3 nen par. 3.1, Nr. 08/L-109, të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit, që të dy shumat brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Në bazë të nenit 269 par.3 të KPRK-së, i konfiskohen në mënyrë të përhershme substancat narkotike llojit Kanabis (Marihuanë) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), në peshë neto : 1.38=0,0001 gram, e cila i është gjetur të pandehurit gjatë kontrollës nga policia.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.868/24, e dt.10.10.2024, ka ngarkuar të pandehurin për shkak të kryerjes së veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi veprat penale për të cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku janë kryer ose tentohet të kryhen veprat penale.

Gjykata duke vepruar sipas akuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 01.11.2024, në të cilën seancë kane prezantuar prokurori i shtetit dhe i pandehuri.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka udhëzuar të pandehurin për të drejtat e tija në kuptim të nenin 241 par.1 të KPPRK-së, dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës PP/II.nr. 868/24, e dt.10.10.2024 nga prokurori i shtetit, gjyqtari pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, në pajtim me nenin 241 paragrafi 4 të KPPRK-së, i ka afruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pa fajësinë për veprën penale për të cilën është i akuzuar.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar publik ka deklaruar se, e pranoj fajësinë për veprën penale që më ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave të saja, për veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, jam i njoftuar me pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e fajit e bëj në mënyrë vullnetare, ndihem thellë i penduar, jam i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë,

premtoj se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepër tjetër penale të tillë apo të ngjashme, lus gjykatën që mundësisht të më shqiptoj një dënim sa më të butë që është e mundur.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi, pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi që pranimi është bërë në mënyrë vullnetare në pajtim me dispozitat e nenin 242 të KPRK-së, në mbështetje të provave dhe fakteve që i përmban aktakuza, i propozoj gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj një dënim me të cilin dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, dhe në kuptim të nenit 69 dhe 70 si rrethana rënduese të merr parasysht mënyrën dhe rrethanat nën të cilat është kryer vepra penale dhe shkallën e lartë të dashjes si dhe faktin se i njëjti është kryes i disa veprave penale dhe është i dënuar me aktgjykime të plotfuqishëm në bazë të ekstraktit mbi dënimet të KGJK-së nr....., ndërsa si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë nga i pandehuri. Gjithashtu në kuptim të nenit 269 par.3 të KPRK-së, substanca narkotike e llojit Kanabis (Marihuanë) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), në peshë neto: 1.38=0,0001 gram, të konfiskohet në mënyrë të përhershme.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 par. 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajit është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, pranimi i fajit mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siç janë: Deklarata e të pandehuri: D.H., e dhënë në SP- Ferizaj me datë 05.06.2024, Vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve, i datës 05.06.2024, Raporti i Ekspertimit me numër referues AKF/2024-2398/24-2280 i datës 13.09.2024, Raporti i oficerit i datës 05.06.2024 si dhe shkresat e tjera që gjenden në lëndë.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjykata në bazë të nenit 242, paragrafi 6, të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit. (*nëse i pandehuri në shqyrtim fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të gjykatës supreme të evidentuar si GJA nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik, gjykata gjeti se në veprimin e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në të cilin është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra apo rrethanat e kryerjes së veprës penale, për çka dhe i pandehuri u shpallë fajtor dhe ju shqiptua dënim siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i pandehuri e ka bërë pranimin e fajësisë, duke e shprehur pendimin e dhe keqardhjen për veprën penale të kryer, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsërit vepër të tillë apo të ngjashme, ndërsa rastin konkret si rrethana rënduese gjeti se i pandehuri edhe më parë është i gjykuar dhe dënuar për vepra penale të ndryshme siç shihet nga Ekstrakti mbi dënimet penale të nxjerra nga Departamenti i Evidencës Qendrore Penale të KGJK dhe ate me aktgjykimet e plotfuqishme P-18/2018 të dt. 20.03.2018, për vepër penale “Ngacmimi” nga neni 186 i KPRK-së, me dënim me gjobë, me aktgjykimin e plotfuqishëm P.1710/2019 të dt. 08.06.2019, për vepër penale “Kanosja” nga neni 185 i KPRK-së, me dënim me gjobë, me aktgjykimin e plotfuqishëm P.455/2019 të dt.18.12.2019, për vepër penale “Kanosja” nga neni 185 i KPRK-së, me dënim me gjobë dhe me aktgjykimin e plotfuqishëm P.791/2021 të dt.30.05.2024, për vepër penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së, me dënim me gjobë dhe përveç rrethanave të sipërpërmendura gjykata që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar me kusht është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes së veprës penale, rrezikshmërisë së sajë dhe autoritetit të saj, që do të shërbejë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi për konfiskimin në mënyrë të përhershme të substancës narkotike llojit marihuanë, është marrur konform nenit 269 par.3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle, është marr në kuptim të dispozitës së nenit 452 par.1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 36 par 3 pika 3.1, Nr. 08/L-109 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të theksuarave më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ,
DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL
2024:285453, i datës 07.11.2024**

**Zyrtare ligjore
Kimete Bytyqi**

**Gjyqtari i vetëm gjykues:
Imri Sejda**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.